

## **Njoftim për pjesëmarrjen e personelit ushtarak mjek në provimin e specializimit të mjekësisë, në Turqi.**

Zyra e atasheut ushtarak të Republikës së Turqisë, në Tiranë, informon se në periudhën e pranverës të vitit 2018, do të zhvillohet provimi i specializimit në mjekësi, pranë Universitetit të Shkencave Mjekësore, në Turqi.

Kushtet e aplikimit për pjesëmarrje në testim:

Për personelin që ka përfunduar studimet pranë Fakulteteve të Mjekësisë, në Turqi, duhet domosdoshmërisht të ketë marrë pjesë dhe të jetë vlerësuar pozitivisht në provimin e gjuhës së huaj që zhvillohet pranë Qendrës së Vlerësimit, Përzgjedhjes dhe Regjistrimit, në Turqi ose të jetë pajisur me një vërtetim ndërkombëtar të gjuhës së huaj.

Personeli që nuk ka përfunduar studimet pranë Fakulteteve të Mjekësisë në Turqi, duhet të ketë marrë pjesë dhe të jetë vlerësuar pozitivisht në provimin e gjuhës së huaj që zhvillohet pranë Qendrës së Vlerësimit, Përzgjedhjes dhe Regjistrimit, në Turqi ose të jetë pajisur me një vërtetim ndërkombëtar të gjuhës së huaj.

Përpara pjesëmarrjes në provimin e specializimit të mjekësisë, kandidatët duhet të kenë marrë pjesë dhe të jenë kualifikuar në provimin e përcaktimit të nivelit të dijeve, i cili organizohet nga Institucioni i Arsimit të Lartë që ka tagrin e njësimit të diplomës.

Specialitetet e ofruara nga pala turke janë si më poshtë vijon:

1. Emergency medicine
2. Forensic medicine
3. Pediatrics
4. Family medicine
5. Physical medicine and rehabilitation
6. General surgery
7. Chest surgery
8. Ophtalmology
9. Internal medicine
10. Obstetrics and gynecology
11. Cardiovascular and thoracic surgery
12. Anatomy
13. Pediatric surgery
14. Neurology
15. Nuclear medicine
16. Child and adolescent psychiatry
17. Plastic reconstructive and aesthetic surgery
18. Radiology
19. Medical biochemistry
20. Medical pathology
21. Urology
22. Infectious diseases and clinical microbiology
23. Chest deseases
24. Psychiatry
25. Undersea and hyperbaric medicine
26. Medical farmacology

27. Medical histology and embryology

28. Medical microbiology

Informacionet e detajuara në lidhje me provimin e lartpërmendur gjenden në adresën [www.osym.gov.tr](http://www.osym.gov.tr).

Aplikimet do të kryhen online nga vetë personeli i interesuar në të njëjtën adresë.